




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Општина Грачаница
Komuna e Graçanicës
Municipality of Gračanica



STATUTI I
NDËRMARRJES PUBLIKE-KOMUNALE
“EKOLOGJIA” Sh.A. GRAÇANICË

Graçanicë
Korrik, viti 2026

Në bazë të nenit 5 paragrafi 1 pika c), nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 17 paragrafi 1 pika f dhe p) të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr. 28/2008), nenit 15 dhe nenit 34 të Ligjit nr.06/L-016 për shoqëritë tregtare ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.09/2018), nenit 4 paragrafi 1 dhe nenit 11 të Ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr. 31/2008), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.13/2012), Ligjin nr.05/L-009 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.10/2015) dhe Ligjin nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, nenit 4 të Rregullores nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.19/2015, si dhe paragrafit 4 dhe 5 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Ndërmarrjes publike "Ekologjia" Sh.A, Graçanicë (nr.14/149 i datës 17.07.2017), Kuvendi i Komunës së Graçanicës me Vendimin nr.2254/26 të datës 26.05.2026 i miraton ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Ndërmarrjes publike-komunale "Ekologjia" Sh.A. Graçanicë:

S T A T U T I I

Ndërmarrjes publike-komunale "Ekologjia" Sh.A. Graçanicë

Nr.5754/17 të datës 06.09.2017 me ndryshimet dhe plotësimet nr.4070/20 të datës 07.08.2020, nr.1536/23 të datës 06.04.2023, nr.3378/23 të datës 16.06.2023 dhe nr.2254/26 të datës 26.05.2026

Dispozitat e përgjithshme Neni 1

Ndërmarrja publike - komunale "Ekologjia" Sh.A. Graçanicë (në tekstin e mëtejshëm: Ndërmarrje) është një ndërmarrje sapo e themeluar publike lokale me qëllim të kryerjes së punëve të interesit publik dhe ofrimit të shërbimeve publike komunale në territorin e Komunës së Graçanicës dhe më gjerë, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 2

Me Statutin e Ndërmarrjes publike - komunale "Ekologjia" Sh.A. Graçanicë (në tekstin e mëtejshëm: Statut) rregullohet statusi juridik i ndërmarrjes, emri dhe selia e ndërmarrjes, veprimtaria e ndërmarrjes, vula dhe shtambili i ndërmarrjes, themeluesi i ndërmarrjes, kapitali themeltar, pasuria e ndërmarrjes, kohëzgjatja e ndërmarrjes, organet dhe mënyra e zgjedhjes së organeve, raporti ndërmjet themeluesit dhe ndërmarrjes, statusi juridiko-punues i të punësuarve, aktet e përgjithshme të ndërmarrjes, mbrojtja e mjedisit, shpërbërja dhe likuidimi i ndërmarrjes, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Statusi juridik i ndërmarrjes

Neni 3

Ndërmarrja e organizuar si një njësi e vetme organizative me status të personit juridik ka zotësi juridike që të:

1. Padisë dhe të jetë e paditur para gjykatave;
2. Posedojë dhe administrojë pasurinë;
3. Lidh kontrata;
4. Zgjedh dhe t'i shkarkojë drejtorët, zyrtarët dhe të punësuarit, në përputhje me ligjin;
5. Kryejë edhe aktivitete të tjera të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të saj, në përputhje me ligjet në fuqi.

Emri dhe selia e ndërmarrjes

Neni 4

1. Emri i plotë i ndërmarrjes është: Ndërmarrja publike - komunale "Ekologjia" Sh.A. Graçanicë.
2. Emërtimi i shkurtër i ndërmarrjes është: NPK "Ekologjia" Sh.A. Graçanicë.
3. Selia e ndërmarrjes është në Graçanicë, rruga "Car Lazar" p.n. objekti i Qendrës tregtare, 10500 Graçanicë.

Veprimtaria e ndërmarrjes

Neni 5

Aktivitetet themelore dhe dominuese të ndërmarrjes janë:

1. Mbledhja, largimi dhe transportimi i mbeturina;
2. Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara dhe publike;
3. Pastrimi dhe heqja e deponive të egra;
4. Mirëmbajtja e rrugëve lokale;
5. Mirëmbajtja e rrugëve lokale në kushtet e dimrit;
6. Mirëmbajtja e oxhaqeve të ekonomive familjare dhe objekteve të tjera;
7. Organizimi dhe mirëmbajtja e tregjeve;
8. Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave lokale;
9. Organizimi i varrimit dhe ndërtimi i përmendores;
10. Mirëmbajtja e ndriçimit publik lokal;
11. Mirëmbajtja e rrjetit lokal të kanalizimit;
12. Shërbime të makinerive ndërtimore që lidhen me aktivitetet komunale, punimet e dheut, gërmimet e kanaleve të shiut dhe kanaleve për vendosjen e ujësjellësit, kanalizimit dhe të tjera, largimin e mbeturinave ndërtimore dhe dheut, rregullimin e hapësirave publike.
13. Aktivitete artizanale - punime metalike dhe përpunim metalesh që lidhen me aktivitetet komunale dhe kanë të bëjnë me prodhimin e llojeve të ndryshme të kontejnerëve dhe bokseve për asgjësimin e mbeturinave dhe shitjen e tyre;
14. 8121 - Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave;
15. 3700 - Kanalizimi;

16. 4211- Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave;
17. 8122 - Aktivitetet e tjera të pastrimit të ndërtesave dhe objekteve;
18. 8129 - Aktivitetet e tjera të pastrimit;
19. 8130 - Aktivitete shërbimi të rregullimit dhe mirëmbajtjes së mjedisit;
20. 9603 - Shërbimet funerale dhe aktivitetet e lidhura me to.
21. 9609 - Aktivitetet e tjera p.k.t.

2. Për kryerjen e aktiviteteve të lartpërmendurat ndërmarrja do të ndërmarrë masa për marrjen e të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshme nga organet kompetente.

Vula dhe shtambili i ndërmarrjes

Neni 6

1. Ndërmarrja ka vulën e vet e cila është në formë të rrumbullakët, brenda të të cilës në rrathët koncentrikë është shkruar emri i plotë i ndërmarrjes si më poshtë:

në rrathën e parë është shkruar në gjuhën serbe dhe me alfabet cirilik:

“Јавно-комунално предузеће „Екологија“ Д.Д. Грачаница”

në rrathën e dytë është shkruar në gjuhën shqipe dhe me alfabet latin:

”Ndërmarrja publike - komunale “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë”

2. Ndërmarrja ka shtambilin e vet të pranimit në formë drejtkëndshit dhe përmban emrin e plotë të ndërmarrjes me një hapësirë për vendosjen e numri dhe datës, të shkruar në gjuhën serbe-me alfabet cirilik dhe në gjuhën shqipe - me alfabet latin.

3. Mënyra e përdorimit dhe ruajtjes së vulës dhe shtambilit të pranimit së ndërmarrjes rregullohen me një akt të veçantë të nxjerr nga Bordi i drejtorëve.

Themeluesi i ndërmarrjes

Neni 7

Themelues i ndërmarrjes dhe pronar me 100 % të aksioneve është Komuna e Graçanicës, me seli në Graçanicë, rruga “Car Lazar” p.n. 10500 Graçanicë.

Raporti në mes të themeluesit dhe ndërmarrjes

Neni 8

1. Pas regjistrimit të ndërmarrjes, themeluesi nuk e menaxhon as nuk e udhëheq ndërmarrjen dhe gjithashtu nuk është i detyruar që të financojë biznesin e ndërmarrjes.

2. Transferimi i pronësisë ose çdo transferim tjetër i pronësisë të ndërmarrjes nuk do të jetë i mundur pa pëlqimin dhe miratimin e dhënë nga themeluesi.

Kapitali themeltor i ndërmarrjes

Neni 9

1. Kapitali themeltar i ndërmarrjes është 10.000 (dhjetë mijë) euro.

2. Kapitali themeltar i ndërmarrjes është i ndarë në aksione, ku vlera individuale nominale është 1

(një) euro cent.

3. Kapitali themeltar në tërësi 100% sigurohet nga themeluesi.

Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

Neni 10

Vendimin për rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të ndërmarrjes mund ta nxjerr vetëm organi kompetent i themeluesit.

Shpërndarja e fitimeve dhe mbulimi i humbjeve

Neni 11

Vendimi për shpërndarjen e fitimeve apo mbulimin e humbjeve të ndërmarrjes nxirret nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, me pëlqimin e themeluesit.

Pasuria e ndërmarrjes

Neni 12

1. Ndërmarrja mund të fitojë të drejtën mbi pronën e luajtshme dhe të paluajtshme, letrat e vlefshme dhe të drejtat e tjera pronësore.

2. Ndërmarrja për detyrimet e veta përgjigjet me gjithë pasurinë e saj.

Kohëzgjatja e ndërmarrjes

Neni 13

Ndërmarrja themelohet si një shoqëri aksionare e përhershme dhe e pakufizuar kohore.

Komisioni Komunal i Aksionarëve

Përbërja

Neni 14

1. Komisioni Komunal i Aksionarëve i ushtron në emër të themeluesit të drejtat dhe detyrimet e parapara me ligj të aksionarëve.

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve përbëhet nga tre (3) anëtarë, të cilët emërohet në përputhje me nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

1. Komisioni Komunal i Aksionarëve përbëhet nga tre anëtarë:

1. Sasha Daniq (*Saša Danić*), me propozim të kryetarit të komunës;

2. Marija Steviq (*Marija Stević*), me propozim të Kuvendit komunal (KK);

3. Dejan Bozhidareviq (*Dejan Božidarević*), me propozim të Kuvedit komunal (KK).

1. Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve me votat e shumicës e zgjedhin kryesuesin.

2. Mandati i anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve zgjat 3 vjet.

3. Mandati i anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve do të pushojë para skadimit të mandatit në rastin e:

1. Shkarkimit nga organi kompetent i themeluesit;

2. Dorëzimit të dorëheqjes me shkrim;

3. Vdekjes;
4. Në raste të tjera të parashikuara me ligj.

Përgjegjësia e Komisionit Komunal të Aksionarëve

Neni 15

Komisioni Komunal i Aksionarëve për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe kryetarit të komunës, i cili është i detyruar që ta dorëzojë së paku një herë në vit raportin mbi punën dhe biznesin e ndërmarrjes dhe organeve të saj.

Kompetencat e Komisionit Komunal të Aksionarëve

Neni 16

Komisioni Komunal i Aksionarëve ka këto kompetenca:

1. Zgjedh dhe shkarkon 4 drejtorë të Bordit të drejtorëve;
2. I miraton ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të ndërmarrjes, me pëlqimin e themeluesit;
3. E nxjerr vendimin për lartësinë e kompensimit për drejtorët e Bordit të drejtorëve;
4. E nxjerr vendimin për pagesën e dividendëve;
5. Ia paraqet raportin vjetor për punën e vet organit kompetent të themeluesit;
6. Jep autorizime për bashkimin e ndërmarrjes;
7. E nxjerr vendimin për shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve, me pëlqimin e themeluesit;
8. E nxjerr vendimin për shpërbërjen e ndërmarrjes;
9. E miraton raportin financiar vjetor të operimit të ndërmarrjes;
10. Kryen edhe punë dhe detyra të tjera në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Takimet e Komisionit Komunal të Aksionarëve

Neni 17

1. Komisioni Komunal i Aksionarëve është i detyruar të mbajë së paku një mbledhje të rregullt vjetore. Mbledhja vjetore zhvillohet brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të raportit financiar vjetor të Bordit të drejtorëve, më së voni deri më 31 mars të vitit vijues.

2. Përveç mbledhjes së rregullt vjetore, mund të mbahen edhe mbledhjet e jashtëzakonshme me kërkesë të:

1. Kryetarit të komunës;
2. Kuvendit të komunës;
3. Bordit të drejtorëve;
4. Gjykatës kompetente.

3. Mbledhjet mund të mbahen nëse në to marrin pjesë të paktën 2 anëtarë të komisionit.

4. Mbledhjet sipas rregullave mbahen në selinë e themeluesit, përkatësisht në ndërtesën e Komunës së Graçanicës.

5. Mbledhjet thirren dhe udhëhiqen nga kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve, ose në rast të mungesës së tij nga anëtarë i cili është përcaktuar me shkrim nga ana e tij. Data, koha, vendi dhe rendi i ditës së mbledhjes përcaktohen në ftesën për mbledhjen e Komisionit komunal të aksionarëve.

6. Nga çdo mbledhje të komisionit do të përpilohet procesverbali i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Komisionit.

7. Komisioni Komunal i Aksionarëve nxjerr Rregulloren e punës.

8. Vendimet merren nëse për çdo vendim voton së paku dy (2) anëtarë të Komisionit.

Bordi i drejtorëve Përbërja dhe zgjedhja e drejtorit Neni 18

1. Bordi i drejtorëve i ndërmarrjes përbëhet nga pesë (5) drejtorë.

2. Katër (4) drejtorë të ndërmarrjes zgjidhen nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, në bazë të thirrjes publike për paraqitjen e aplikacioneve, e cila do të jetë e hapur 15 ditë nga dita e publikimit të thirrjes publike. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve detyrimisht duhet të respektohen dispozitat e Ligjit për barazi gjinore. Anëtari i pestë i Bordit të drejtorëve është Drejtori ekzekutiv, i zgjedhur nga Bordi i drejtorëve, në përputhje me dispozitat e nenit 21 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

3. Si drejtor mund të zgjidhet vetëm personi i cili i plotëson kushtet për pavarësi dhe përshtatshmëri profesionale të përcaktuara në nenin 17 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për ndërmarrjet publike, dhe nëse e ka japë deklaratën nën betim të përcaktuar në nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

4. Të paktën dy drejtorë të zgjedhur duhet të jenë ekspertë, ose të kenë njohuri adekuate në fushën e kontabilitetit, siç kërkohet me nenin 17.4 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

5. Bordi i drejtorëve të NPK-së, menjëherë pas përzgjedhjes, do ta zgjedhë një nga anëtarët e tij për të shërbyer si kryesues. Asnjë anëtar i Bordit të drejtorëve të NPK-së, përveç Drejtorit ekzekutiv të NPK-së, nuk do të ketë pushtet ekzekutiv. Drejtori ekzekutiv nuk do të shërbejë si kryesues ose si ushtrues detyre të kryetarit të Bordit të drejtorëve.

6. Sipas vendimit të Komitetit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes, të regjistruar me numër 2070/23 të datës 15.06.2023, katër (4) drejtorë të Bordit të NPK "Ekologija" SH.A. janë:

1. Marina Sllaviq (*Marina Slavić*);

2. Alleksandra Smiljiq (*Aleksandra Smiljić*);

3. Dejan Stanojeviq (*Dejan Stanojević*);

4. Aziz Karadollami (*Aziz Karadolami*).

Anëtari i pestë i Bordit të drejtorëve, sipas funksionit të Drejtorit ekzekutiv, është:

1. Sllagjana Mirković (*Sladana Mirković*).

Mandati i drejtorëve të Bordit të drejtorëve Neni 19

1. Mandati i drejtorëve zgjat tre (3) vjet nga dita e zgjedhjes.

2. Në rast të ndërprerjes së mandatit, drejtori e kryen detyrën deri në emërimin e një drejtori të ri për detyrë.

3. Mandati i drejtorit pushon para skadimit të mandatit në rast të:

1. Shkarkimit nga Komisioni Komunal i Aksionarëve;

2. Dorëzimit të dorëheqjes me shkrim;

3. Vdekjes;

4. Në raste të tjera të parashikuara me ligj.

5. Komisioni Komunal i Aksionarëve në rast të marrjes së informatave konfidenciale që Bordi i drejtorëve apo dikush nga drejtorët individualisht vepron në kundërshtim me detyrat ose interesat e besuara të ndërmarrjes, mundet pa vonesë ta zbatojë hetimin dhe ta shkarkojë të gjithë Bordin e drejtorëve apo drejtorët individualisht nëse kanë bindje të qartë se kanë bërë shkelje në punë.
6. Drejtori mund të japë dorëheqjen në çdo kohë. Në rast të dorëheqjes, mandati i drejtorit përfundon në ditën e shënuar në dorëheqjen ose në ditën e dorëzimit të dorëheqjes me shkrim.

Kompetencat e Bordit të drejtorëve

Neni 20

Bordi i drejtorëve ka këto kompetenca:

1. Nxjerr dhe miraton planin e punës dhe buxhetin e ndërmarrjes për çdo vit kalendarik;
2. Përcakton lartësinë e tarifës për ofrimin e shërbimeve të ndërmarrjes;
3. Zgjedh dhe shkarkon kryeshefin ekzekutiv të ndërmarrjes;
4. Zgjedh dhe shkarkon zyrtarët e ndërmarrjes, përveç zyrtarit të auditimit;
5. Kryen monitorimin e vazhdueshëm të punës së ndërmarrjes;
6. Kryen monitorimin e punës të drejtorit ekzekutiv dhe zyrtarëve të ndërmarrjes;
7. Cakton mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Bordit;
8. Përcakton lartësinë e kompensimit të zyrtarëve të ndërmarrjes;
9. Themelon komisione për çështjet e caktuara;
10. Miraton rregullore dhe akt të tjera të parapara me këtë Statut;
11. Së paku një herë në vit kryen një vlerësim sistematik të përmbushjes së detyrimeve të vet;
12. Miraton strategji dhe plane gjithëpërfshirëse të punës së ndërmarrjes;
13. Miraton raporte tremujore dhe vjetore të punës së ndërmarrjes;
14. Kryen edhe detyra të tjera që janë të nevojshme për punën e kompanisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Trajnimi i drejtorëve të Bordit të drejtorëve

Neni 21

1. Të gjithë drejtorët e ndërmarrjes të paktën një herë në vit janë të detyruar që të marrin pjesë në trajnime për menaxhimin korporativ të organizuar nga Njësia për Politikë dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.
2. Mospërgjigja ndaj ftesës për pjesëmarrje në trajnim paraqet arsyen për shkarkimin e drejtorit edhe para skadimit të mandatit për të cilën ai u emërua.

Zgjedhja e kryesuesit të Bordit të drejtorëve

Neni 22

1. Bordi i drejtorëve menjëherë pas zgjedhjes dhe marrjes së detyrës, do të zgjedhë me shumicën e votave njërin nga anëtarët e tij si kryesues.
2. Anëtarët e Bordit të drejtorëve, duke përfshirë edhe kryesuesin, nuk kanë kompetenca ekzekutive përveç drejtorit ekzekutiv.

Mbledhjet e Bordit të drejtorëve

Neni 23

1. Bordi i drejtorëve është i detyruar të mbajë së paku një mbledhje të rregullt vjetore.
2. Përveç mbledhejs së rregullt vjetore, mund të mbahen edhe mbledhjet e jashtëzakonshme me kërkesë të:
 1. Kryesuesit të Bordit të drejtorëve;
 2. Shumicës së anëtarëve të Bordit të drejtorëve;
 3. Komisionit Komunal të Aksionarëve;
 4. Kryetarit të komunës;
 5. Kuvendit të komunës.
3. Kryesuesi thërret mbledhjet e Bordit të drejtorëve dhe i kryeson ato.
4. Nëse në mbledhje nuk merr pjesë kryesuesi, si kryesues i kësaj mbledhjeje do të jetë drejtori i cili do të zgjidhet me votat e shumicës së drejtorëve të pranishëm në mbledhje.
5. Mbledhja e Bordit të drejtorëve mund të mbahet nëse në to marrin pjesë shumica e anëtarëve. Në rast të numrit të barabartë të votash, vota e kryesuesit do të jetë vendimtare.
6. Mbledhjet sipas rregullave mbahen në selinë e ndërmarrjes.
7. Për çdo mbledhje të Bordit të drejtorëve mbahet procesverbali, i cili përmban vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes, personat e pranishëm në mbledhje, rendin e ditës, përshkrimin e shkurtët të çështjeve për të cilat është diskutuar, vendimet e marra, mënyrën e votimit për vendimet dhe çështjet e tjera që konsiderohen si të rëndësishme. Procesverbali nënshkruhet nga personi i cili e kryesoi mbledhjen dhe nga sekretari i ndërmarrjes.
8. Bordi i drejtorëve e harton edhe Rregulloren e punës.
9. Për çdo vendim të marrë nga Bordi i drejtorëve duhet të votojë shumica e anëtarëve.

Miratimi i planit të biznesit

Neni 24

1. Plani i biznesit i ndërmarrjes për çdo vit kalendarik për Bordin e drejtorëve përgatitet dhe dorëzohet nga ana e zyrtarëve të ndërmarrjes, më së voni deri më 31 tetor të vitit vijues.
2. Pas miratimit të planit të biznesit, brenda 7 ditëve, Bordi i drejtorëve e paraqet planin e biznesit para Komisionit Komunal të Aksionarëve me qëllim të informimit.

Kompensimi për drejtorin e Bordit të drejtorëve

Neni 25

1. Drejtorët për punën e tyre kanë të drejtë në:
 1. Honorar;
 2. Kompensim.
2. Lartësia e honorarit për drejtorin në fjalë përcaktohet me vendim të Komisionit Komunal të Aksionarëve në përputhje me nenin 20.2 dhe nenin 20.3 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

3. Lartësia e kompensimit përcaktohet nga Komisionit për auditim sipas kritereve të përcaktuara me nenin 20 paragrafi 5 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

4. Për pagesën e honorarit dhe kompensimit mjetet sigurohen nga buxheti i ndërmarrjes.

5. Përveç honorarit dhe kompensimit, drejtorët nuk kanë të drejtë për ndonjë lloj tjetër të kompensimeve ose të privilegjit nga ndërmarrja.

Zyrtarët e ndërmarrjes

Përbërja dhe zgjedhja

Neni 26

Ndërmarrja ka 4 zyrtarë kryesorë dhe atë:

1. Shefin e Shërbimit Administrativ;
2. Shefin e Shërbimit të Financave dhe Thesarit;
3. Sekretarin gjeneral;
4. Zyrтарin për auditimin e brendshëm.

2. Zgjedhja e zyrtarëve të ndërmarrjes, përveç zyrtarit për auditimin e brendshëm, bëhet nga Bordi i drejtorëve pas zbatimit të konkursit publik dhe transparent, në përputhje me rregullat në fuqi.

3. Zgjedhja dhe shkarkimi i zyrtarit për auditimin e brendshëm bëhet nga Komisioni për auditim, në përputhje me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

4. Për të qenë i zgjedhur si zyrtar i ndërmarrjes, personi duhet t'i plotësojë kushtet e parapara me nenin 21 paragrafi 4 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

5. Zyrtarët e ndërmarrjes në çdo kohë mund të shkarkohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Drejtori ekzekutiv

Zgjedhja

Neni 27

1. Drejtori ekzekutiv i ndërmarrjes emërohet dhe shkarkohet nga Bordi i drejtorëve.

2. Në bazë të Vendimit të Bordit të drejtorëve të NPK "Ekologjia", të regjistruar me numër 181/2026 të datës 11.03.2026, si Drejtor ekzekutiv i ndërmarrjes është emëruar Sllagjana Mirković (*Slađana Mirković*), me numër personal: 1174242352.

Personi i autorizuar i NPK "Ekologjia" SH.A. Graçanicë është Drejtori ekzekutiv – Sllagjana Mirković (*Slađana Mirković*).

3. Drejtori ekzekutiv është anëtar, por ai nuk mund të jetë kryesues e as ushtrues i detyrës së kryesuesit të Bordit të drejtorëve.

3. Drejtori ekzekutiv për punën e vet i përgjigjet Bordit të drejtorëve.

Kompetenca

Neni 28

Drejtori ekzekutiv ka këto kompetenca:

1. Përfaqëson ndërmarrjen;
2. Përgjigjet për ligjshmërinë e punës së ndërmarrjes;

3. Zbaton vendimet e Bordit të drejtorëve;
4. I pranon dhe i shkarkon punonjësit e ndërmarrjes;
5. I kryen edhe punët e tjera të nevojshme për funksionimin e ndërmarrjes.

Shkarkimi

Neni 29

1. Bordi i drejtorëve mund të kërkojë nga drejtori ekzekutiv një raport të veçantë nëse vërehet se kryerja e detyrave të ndërmarrjes devijon nga plani i biznesit për vitin aktual fiskal.
2. Bordi i drejtorëve mund ta shkarkojë drejtorin ekzekutiv nëse konstaton se ai për dy vjet radhazi devijon nga realizimi i objektivave të ndërmarrjes. Në këtë rast, Bordi i drejtorëve është i detyruar që ta informojë me shkrim Komisionin Komunal të Aksionarëve për vendimet dhe veprimet e vet.

Shefi i Shërbimit të Financave dhe Thesarit

Neni 30

Shefi i Shërbimit të Financave dhe Thesarit ka këto kompetenca:

1. Çdo ditë i mirëmban llogaritë e ndërmarrjes;
2. I kryen transaksionet financiare të ndërmarrjes;
3. E kontrollon pagesën e faturave;
4. E kryen kontrollin financiar të pasurisë dhe të parave të gatshme;
5. I përgatit raportet financiare të ndërmarrjes;
6. E menaxhon thesarin e ndërmarrjes;
7. E harton dhe e propozon buxhetin e ndërmarrjes;
8. I kryen edhe punët e tjera të nevojshme.

Me shefin e Shërbimit të Financave lidhet kontrata e punës në përputhje me ligjin.

Zyrtari për auditimin e brendshëm

Neni 31

Zyrtari për auditimin e brendshëm ka këto kompetenca:

1. E udhëheq dhe e organizon sistemin e auditimit të brendshëm;
2. I zbaton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm;
3. I kryen detyrat e dhëna nga Komisioni për auditim;
4. I kryen edhe punët e tjera të nevojshme.

Me zyrtarin për auditimin e brendshëm lidhet kontrata e punës në përputhje me ligjin.

Sekretari gjeneral

Neni 32

Sekretari gjeneral ka këto kompetenca:

1. E mirëmban regjistrin e të dhënave të ndërmarrjes;
2. Është personi i autorizuar për pranimin e të gjitha njoftimeve në emër të ndërmarrjes;
3. I përgatit aktet juridike për nevojat e ndërmarrjes;

4. I përgatit kontratat për të punonjësit;
 5. E përfaqëson ndërmarrjen para gjykatave kompetente;
 6. E mban procesverbalin nga mbledhjet e Bordit të drejtorëve;
 7. Kujdeset për dokumentacionin dhe arkivin e ndërmarrjes;
 8. I kryen edhe punët e tjera të nevojshme.
- Me sekretarin gjeneral lidhet kontrata e punës në përputhje me ligjin.

Kompensimi për zyrtarin e ndërmarrjes **Neni 33**

1. Zyrtarët për punën e tyre kanë të drejtë në kompensim, lartësia e të cilit përcaktohet nga Bordi i drejtorëve me një vendim, në përputhje me deklaratën mbi politikën për kompensim, e cila merret nga Komisioni për auditim.
2. Mjetet për kompensimin e zyrtarëve të ndërmarrjes paguhet nga buxheti i ndërmarrjes.

Raporti për biznesin e ndërmarrjes **Neni 34**

1. Zyrtarët e ndërmarrjes i paraqesin Bordit të drejtorëve një raport për çdo tremujor të përfunduar, brenda 30 ditëve nga përfundimi i tremujorit.
2. Zyrtarët e ndërmarrjes janë të detyruar që, brenda 45 ditëve nga dita e përfundimit të vitit kalendarik, t'i paraqesin Bordit të drejtorëve një raport vjetor mbi punën dhe biznesin e ndërmarrjes.
3. Pas aprovimit të raporteve tremujore dhe vjetore, Bordi i drejtorëve ia dorëzon të njëjtat raportet Komisionit Komunal të Aksionarëve dhe kryetarit të komunës të njëjtat raportet me qëllim të informimit.

Komisioni për auditim **Përbërja dhe zgjedhja** **Neni 35**

1. Komisioni për auditim përbëhet nga tre drejtorë, dy prej të cilëve duhet të jenë ekspertë ose të kenë njohuri të përkatëse nga fusha e kontabilitetit.
2. Drejtori ekzekutiv ose kryesuesi i Bordit të drejtorëve nuk mund të jenë anëtarët e Komisionit për auditim.
3. Komisioni për auditim emërohet në përputhje me nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

Kompetenca **Neni 36**

Komisioni për auditim ka juridiksion ekskluziv në përputhje me nenin 25 dhe 26 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

Auditimi i jashtëm **Neni 37**

1. Biznesi i ndërmarrjes i nënshtrohet gjithashtu auditimit vjetor të pasqyrave financiare nga Zyra

e Auditorit të Përgjithshëm ose nga auditorët që do të zgjidhen në përputhje me nenin 33 paragrafi 3 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

2. Mosmarrja e masave për zbatimin e rekomandimit të auditimit të jashtëm nga një drejtor ose një punonjës i ndërmarrjes përbën një arsye për shkarkimin e tyre nga ana e organeve kompetente.

Konflikti i interesit

Neni 38

1. Çdo drejtor dhe punonjës i ndërmarrjes është i detyruar t'i kryejë detyrat dhe punët e tij në mënyrë të ndërgjegjshme, të përgjegjshme, efikase, në interes të ndërmarrjes, duke respektuar të gjithë legjislacionin e aplikueshëm ligjor dhe nënligjor.

2. Çdo drejtor ose punonjës i ndërmarrjes është i detyruar të njoftojë Bordin e drejtorëve në rast se ekziston dyshimi për konflikt interesi në marrjen e vendimit.

Punonjësit e ndërmarrjes

Neni 39

1. Statusi punues-juridik i punonjësve të ndërmarrjes rregullohet me Ligjin e punës, marrëveshjen kolektive, aktet e brendshme të punëdhënësit.

2. Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve brenda ndërmarrjes nxirret nga Bordi i drejtorëve.

Mbrojtja në punë

Neni 40

1. Ndërmarrja është e detyruar të marrë të gjitha masat për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve në punë të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore.

2. Rregullorja për sigurinë dhe mbrojtjen në punë nxirret nga Bordi i drejtorëve.

Mbrojtja e mjedisit

Neni 41

Në punën e saj, ndërmarrja është e detyruar të respektojë rregullat në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të kryejë aktivitetet e saj në përputhje me parimin e mbrojtjes së mjedisit.

Kodi etik i menaxhimit

Neni 42

1. Ndërmarrja ka Kodin e saj etik për menaxhimin korporativ, të cilin duhet ta nënshkruajnë të gjithë drejtorët dhe punonjësit e ndërmarrjes.

2. Kodi etik për menaxhimin korporativ nxirret nga Bordi i drejtorëve.

Faqja zyrtare e internetit të ndërmarrjes

Neni 43

1. Ndërmarrja do ta regjistrojë dhe do ta mirëmbajë rregullisht faqen zyrtare të internetit të ndërmarrjes, në përputhje me rregullat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Në faqen zyrtare të internetit do të publikohen të gjitha dokumentet dhe kontratat që janë të rëndësishme për biznesin e ndërmarrjes.

Aktet e ndërmarrjes **Neni 44**

1. Akti kryesor i ndërmarrjes është Statuti.
2. Të gjitha aktet e ndërmarrjes (rregulloret, etj) duhet të jenë në përputhje me Statutin.
3. Në rast të konfliktit të dispozitave të Statutit dhe të akteve të tjera të ndërmarrjes, do të zbatohen dispozitat e Statutit.

Drejtori fillestar i ndërmarrjes **Neni 45**

1. Themeluesi emëron drejtorin fillestar të ndërmarrjes me një vendim të veçantë.
2. Detyrimi i drejtorit fillestar është të kryejë procesin e regjistrimit dhe themelimit të ndërmarrjes te organet kompetente, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.
3. Mandati i drejtorit fillestar skadon pas regjistrimit të ndërmarrjes, më së voni në ditën e zgjedhjes së drejtorit të Bordit të drejtorëve nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.
4. Për punën e tij, drejtori fillestar nuk ka të drejtë për kompensim monetar.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare **Zbatimi i rregullave ligjore** **Neni 46**

1. Ndaj çdo gjëje që nuk është paraparë dhe rregulluar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit në fuqi për shoqëritë tregtare, Ligjit për ndërmarrjet publike dhe të ligjeve dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.

Shpërndarja dhe likuidimi i ndërmarrjes **Neni 47**

1. Shpërndarja dhe likuidimi i ndërmarrjes kryhet në bazë të vendimeve përkatëse të themeluesit dhe të autoritetit kompetent, në përputhje me dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare.

Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit **Neni 48**

1. Vendimi për ndryshimin, plotësimin, shfuqizimin ose miratimin e një Statuti të ri të ndërmarrjes mund të bëhet vetëm nga organi kompetent - themeluesi.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit bëhen nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.
3. Për çdo ndryshim dhe plotësim të Statutit, të miratuar nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, duhet të merret pëlqimi nga Kuvendi i Komunës së Graçanicës.

Neni 49

1. Ndryshimet dhe plotësimet në Statut do të bëhen në mënyrën e paraparë edhe për miratimin e

tij.

2. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga organi kompetent i themeluesit dhe dorëzimit në Regjistër,

Hyrja në fuqi

Neni 50

1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e publikimit të tij.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević
Milan Dimitrijević